



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër: 400-01/29974/8, dt. 29. Maj 2025.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 al. 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28. datë: 04. Qershor 2008"), nenit 3 paragrafi 3.2. të Rregullores Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime dt. 01. Prill 2016, dhe nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 të dt. 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: **29. Maj 2025**, në propozim të komisionit të kuvendit dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

VENDIM

Nr. 49/2025

**Për dhënien e titullit "Nderi i Qytetit" i Komunës së Pejës,
z. Shkelqim Devolli**

1. Z. Shkelqim Devolli, nga Peja, i jepet titulli **"Nderi i Qytetit" i Komunës së Pejës**, me motivacion:

"Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të qytetit të Pejës dhe Republikës së Kosovës, duk krijuar lidhje miqësore dhe politike me shtete të ndryshme dhe korporata prestigjioze ndërkombëtare. Për hapjen e vendeve të punës dhe mbështetjen e iniciativës lokale. Bashkëthemelues dhe drejtues i "Korporatës Devolli", si korporatë e njohur rajonale me më shumë se 4500 punëtorë me teknologjinë më moderne të kohës, si pasardhëse e Kompanisë "Devolli Commerce".

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Pejës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj